REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

10708

Nr. 10708

Tiranë,më ____________ 1995

# VENDIM

## MBI REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot më datën ______________________, unë Anila Cape, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga

KERKUESI: Mynyr Shehu, biri i Abazit, dtl. 1951, banuese në Pobrat.

OBJEKTI Për rregjistrimin si person juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar sipas nenit 5 të ligjit 7512 datë 10.8.1991 Mbi veprimtarin private

**Konstatova se :**

Dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi Mynyr Shehu për rregjistrimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar SHPK me emërin "Shehu" për të ushtruar veprimtari private është i plotë në bazë të ligjit i cili kërkon rregjistrimin si person juridik me objekt veprimtarie tregëtim karburanti e lubrifikanti, tregëtim artikuj të ndryshëm me shumic e pakinë, tregëtim e prodhim material ndërtimi, si dhe tregëtim armë gjuhetie të import eksportit,

**PER KETO ARSYE**

Në bazë të nenit 5 të ligjit 7512 datë 10.8.1991, të ligjit nr. 7628 datë 19.11.1992, të ligjit 7667 datë 28.1.1993,

**VENDOSA**

Rregjistrimin si person juridik të shoqërisë "SHEHU" si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar SHPK me ortak të vetëm Mynyr Shehu, me objekt veprimtarije, tregëtim karburanti e lubrifikante, artikuj të ndryshëm me shumic e pakicë, prodhim e tregetim të material ndërtimi si dhe tregëtim armë gjuhetije, import eksporti, me kapital themeltar të shoqëris prej 100000 mijë lekë, selia e shoqërisë është në fshatin Pobrat me filiale në Tiranë dhe në Fier, emri i shoqërisë është "SHEHU" me administrator ortaku i vetëm dhe themeluesi i shoqërisë Mynyr Shehu.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në shkallë të dytë.

GJYQTARE
Anila Cape

REPUBLIKA E SHQIPERISË
GJYKATA RRETHIT TIRANË
Nr. 10708/1 i vendimit

V E N D I M
i GJYQTARIT TË VETËM

Në Tiranë sot më datën 7.2.2001 unë [signature] me detyrën e gjyqtares pranë kësaj gjykate mora në shqyrtim kërjesën e paraqitur nga Mynyr Shehu për depozitimin pranë regjistrit tregëtar të kësaj gjykate të vendimit të ortakut të shoqërisë SHEHU shpk dhe :

Konstatova se :

Me vendimin Nr.10708 datë 9.5.1995 është regjistruar si person juridik shoqëria me përgjegjsi të kufizuar SHEHU shpk me ortak zotin Mynyr Shehu.

Me vendimin Nr. 1 datë 5.2.2001 të ortakut të vetëm është vendosur emërimi administrator i zotit Nadir Shehu si dhe miratimi i kontratës shitjes së kapitalit të shoqërisë zotit Nadir.

Kërkesa është e drejtë dhe duhet pranuar.

Për këto arsye

Në bazë të ligjës 7638 datë 19.11.1992 dhe 7667 datë 28.1.1993

V E N D O S A

Pranimin e kërkesës.

Depozitimin pranë regjistrit tregëtar të gjykatës rrethit Tiranë të vendimit Nr. 1 datë 5.2.2001 të ortakut të shoqërisë SHEHU shpk si dhe kontratën e shitjes së kuotës së kapitalit.

Urdhërohet zyra e regjistrit tregëtar të bëj ndryshimer përkatëse në kolonën 2 gërma c si dhe të bëhet ndarja me vijë të kuqe.

G J I Q T A R E
[signature]

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**
**TIRANË**
**Nr. 10708/12 Vendimi**

# VENDIM
## *I GJYQTARIT TË VETËM*

Sot, më datë 06.06.2007, unë gjyqtare e vetme e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ______________, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga z. Nadir Shehu, për depozitimin pranë Regjistrit Tregtar të Vendimit të Ortakut të vetëm të Shoqërisë "SHEHU" sh.p.k, nr. 1, dt. 23.05.2007. Pasi shqyrtova kërkesën e tij,

## KONSTATOVA

- Se me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr. 10708, dt. 9. 05.1995 është regjistruar si person juridik Shoqëria "SHEHU" sh.p.k.

- Me datë 23.05.2007, ortaku i vetëm me Vendim Nr. 1, ka vendosur:

1. Caktimin e ekspertes kontabël të shoqërisë, Semiha Dollani me qëllim vlerësimin e kapitalit dhe shtesës së tij. Rikapitalizimin e fitimit te vitit 2006.

si dhe kërkon që ky vendim të depozitohet pranë Regjistrit Tregtar.

Nga sa më sipër kërkesa e paraqitur është e drejtë dhe e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.

## PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në Ligjin Nr. 7638, të datës 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare";

## VENDOSA

Depozitimin në regjistrin tregtar të Vendimit Nr. 1, dt. 23. 05. 2007, të ortakut të shoqërisë "SHEHU" sh.p.k për caktimin e ekspertes kontabël Zj. Semiha Dollani me qëllim vlerësimin e kapitalit dhe shtesës së tij.
Urdhërimin e zyrës së regjistrit tregtar të bëjë ndryshimet përkatëse me nr. rendor ………………., në kolonën ………………….., duke bërë vijëzimet me bojë të kuqe.

**GJYQTAR**

Tiranë, më 06.06.2007

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË
Nr. 10708/3 Vendimi

**VENDIM**
***I GJYQTARIT TË VETËM***

Sot, më datë 19.06.2007, unë gjyqtare e vetme e Gjykatës Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ______, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga z. Nadir Shehu, për depozitimin pranë Regjistrit Tregtar të Vendimit të Ortakut të Shoqërisë "Shehu" sh.p.k, Dt. 25.05.2007. Pasi shqyrtova kërkesën e tij

**KONSTATOVA**

- Se me Vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë Nr.10708, dt.9.05.1995 është regjistruar si person juridik Shoqëria "Shehu" sh.p.k.
- Me datë 25.05.2007, ortaku i vetëm, me Vendim Nr. 2, ka vendosur:

1. Miratimin e Raportit të Veçantë për vlerësimin e kapitalit dhe të shtesës së tij, hartuar nga ekspertja kontabël Semiha Dollani
2. Të rrisë kapitalin themeltar (kapitali nënshkruar) për shumën 1.993.841 leke e cila përbehet:

a. Fitimi i vitit ne vazhdim 1.993.841 leke

si dhe kërkon që ky vendim të depozitohet pranë Regjistrit Tregtar.

Nga sa më sipër kërkesa e paraqitur është e drejtë dhe e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.

**PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në Ligjin Nr. 7638, të datës 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare";

**VENDOSA**

Depozitimin në regjistrin tregtar të Vendimit Nr. 2, dt. 25.05.2007, të ortakut të shoqërisë "Shehu" sh.p.k për miratimin e raportit të veçantë për vlerësimin e kapitalit dhe të shtesës së tij si dhe për rritjen e kapitalit themeltar të shoqërisë për vlerën 1.993.841 lekë
Urdhërimin e zyrës së regjistrit tregtar të bëjë ndryshimet përkatëse me nr rendor ………………, në kolonën ………………….., duke bërë vijëzimet me bojë të kuqe.

**GJYQTAR**

Tiranë, më 19.06.2007

**AKT THEMELIMI**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "SHEHU"SHPK**

Unë Mynyr Shehu,biri i Abasit,dtl.1955,banues në Pobrat,me cilësinë e ortakut të vetëm,me vullnet të lirë hartoj këtë akt themelimi të një shoqërije me përgjegjësi të kufizuar.

Kjo shoqëri krijohet dhe ushtron veprimtari private në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht për zbatimin e dispozitave të ligjit nr.7512 datë 10.8.1991"Për sanksionimin e mbrojtjen e pronës private,të nismës së lirë,të veprimtarive private të pamvarura dhe privatizimit,të ligjit nr. 7632 datë 4.11.1992 " Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregëtar" të ligjit nr. 7638 datë 19.11.1992" Për shoqëritë tregëtare,të ligjit nr. 7667 datë 28.I.1993" Për rregjistrin tregëtare" si dhe të akteve të tjera ligjore që do të jenë në fuqi gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe me dispozitat e statutit që i bashkangjitet këtij akti themeleimi.

Emërtimi i shoqërisë është "SHEHU" SHPK

Selia e shoqërisë ndodhet në fshatin Pobrat të rrethit Berat.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:Tregëtim karburanti dhe lubrifikante të ndryshme,tregëtim artikuj të ndryshëm me shumicë e pakicë, prodhim e tregëtim material ndërtimi,tregëtim armë gjuhetie,import eksporti.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100000 lekë.

Shoqëria do të administrohet dhe drejtohet prej themeluesit të saj i ili ka të drejtë të caktoj në këtë detyrë edhe persona të tjerë.

Përveç të tjerave aortakut themelues dhe personave të tjerë të caktuar si të tillë nga vet themeluesi e krijuesi i kësaj shoqërie Mynyr Shehu,janë të ngarkuar për të kryer akte dhe veprime të tjera të cilat janë në pajtim me objektin e shoq ërisë dhe kompetencat e tij . Pasi të bëhet rregjistrimi i shoqërisë këto akte i nënështrohen miratimit me qëllim që të bëhet kalimi në ngarkim të shoqërisë. Ortaku themelues dhe personat që mund të caktohen prej tiij si administrator të gjitha ko mpetencat për të kryer formalitetet e hemelimit të parashikuara nga legjislacioni në fuqi .

Ortaku themelues gjithashtu do të veproj në emër të shoqërisë që krijohet gjer në rregjistrimin e saj në gjykatë,pasi shoqëria e fillon veprimin e saj pas rregjistrimit në gjykatë dhe me paisjen e saj me lejen për ushtrimin e kësaj veprimtarije sipas objektit mbas rregjistrimit në organet tatimore të rrethit përkatës.

Kohë zgjatja e kësaj shoqërie do të jetë për një kohë mbi 10 vjet e ripërtëritëshme me përjashtim të rastit,kur ortaku themelues,para kësaj periudhe ose për çdo shkak tjetër të parashikuar në ligj ose në statut vendos që shoqëria të shpërndahet apo të shpërbëhet.

# S T A T U T

## I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "SHEHU" SHPK.

### KREU I I

### Dispozita të përgjithëshme

NENI 1

Shoqëria tregëtare me veprimtari për tregëtimin e karburanteve e lubrifikanteve,artikujve të ndrysh ëm me shumicë e pakicë,prodhimi e tregëtimi materiale ndërtimi dhe armë gjuhetie amport eksporti "SHEHU" SHPK është person juridik i pamvarur,ka të drejta e detyrime për të cilat përgjigjet sipas ligjit 7512 dt.10.8.1991" Për sanksionimin e mbrojtjen e pronës private,të nismës së lirë,të veprimtarisë private të pamvarur dhe privatizimit" të ligjit nr.7638 datë 19.11.1992" Për shoqëritë tregëtare" të ligjit nr. 7667 dt.28.I.1995 "Për regjistrin tregëtar dhe të akteve të tjera ligjore.Shoqëria e ushtron veprimtarin e saj në bazë të ekonomisë së tregut të lirë.

Neni 2

Shoqëria themelohet nga ortaku i vetëm Mynyr Shehu,biri i Abazit, dtl.1959,banues në Pobrat,madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe themelon këtë shoqëri e harton këtë statut me vullnetin e tij të plotë në pajtim me legjislacionin shqiptar.

Neni 3

Shoqëria fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin në Gjykatën e Rrethit Tiranë si person juridik dhe me paisjen e ljese për ushtrimin e kësaj veprimtarie nga zyra tatimore e rrethit Berat.

Neni 4

Emërtimi i kësaj shoqërie do të jetë "Shehu SHPK Pobrat rrethi i Beratit.

Shoqëria do të ketë filialet e saj në Tiranë e Fier,por mund të krijoj filiale edhe në rrethe të tjera të vëndit/

Neni 5

Selia e shoqërisë është në fshatin Pobrat të Rrethit Berat.

KOHË ZGJATJA DHE OBJEKTI I SHOQËRISË

Neni 6

Kohë zgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë mbi 10 vjet

Neni 7

Objekti i shoqërië me përgjegjësi të kufizuar "SHEHU "SHPK,me adresë fshati Pobrat rrethi Berat,me filialet e saj në Tiranë e Fier është:" Tregëtim karburanti e lubrifikante të ndryshme,tregëtim artikuj të ndryshëm me shumicë e pakicë,prodhim e tregëtim material ndërtimi tregëtim armë gjuhetije,import eksporti.

NOTERE SELMA BERAT

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 8

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi fillestar á ortakut të vetëm në masën 100000 lekë.Ky kapital është depozituar në Bankën Bujqësore Berat,ku shoqëria ka llogarin rrjedhëse të saj.

Neni 9

Pjesët e kapitalit themeltar mund të trasferohen në rrugë trashëgimije ose brënda familjes si dhe personave të tjerë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri,por gjithmon sipas pëlqimit të ortakut të vetëm themelues të kësaj shoqërije.

KREI I DYTË

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Ortaku themelues vendos për bilancin vjetor ,për emërimin ose shkarkimin e administratorit,ekspertve kontabël ose likujdeuesave miraton raportet e administrimit dhe të kontrollit,kryen miratimin e llogarive vjetore,inventaret,vendos për shpërbërjen e shoqërisë ose për zgjatjen e veprimtarisë së saj,vendos për ndarjen e fitimeve ose për mbulimin e humbjeve.Rregullon marrdhëniet e punësimit ose të shpërblimit brënda shoqërisë.Realizon detyrimet ndaj organeve shtetërore e personave fizik a juridik vëndas a të huaj.Vendos për ndryshime në statut,por pa prekur qëllimin dhe objektin e veprimtarisë të shoqërisë si dhe të zvogëlimit a zmadhimit të kapitalit themeltar ,vendos për transferimin e pjesve të kapitalit themeltar te të tretët,vendos për shndërrimin e shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të tjera.

Neni 11

Shoqëria ka si administrator ,ortakun e vetëm ,zotin Mynyr Shehu i cili ka kompetencë të caktoj në këtë detyrë një apo disa persona të tjerë.

Neni 12

Administratori ka për detyrë organimin dhe drejtimin e veprimtarisë së shoqërisë. Ai mund të kryejë të gjitha veprimet e administratorit n ë interes të shoqërisë .

Neni 13

Administratori ka kompetencë;

Të miratoj programin e shoqërisë,raportin e administrimit si dhe të gjitha kompetencat e administrimit në interes të shoqërisë dhe në emër të saj,me përjashtim të atyre që ligji dhe statuti ja japin shprehimisht në qoftë se shoqëria do të kthehet në shoqëri me ortak asamblesë së ortakve ose ortakut të vetëm themelues .

Neni 14

Ortaku themles ka të drejtë në çdo kohë të informohet për

veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me gjithë dokumentacionin financiar e llogaritë e shoqërisë.

Neni 15

Në rast nevoje kontrolli i shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar dhe i emëruar nga ortaku themelues.

Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kondita si emërimi në rast se vrehen gabime ose bëhet e pa mundur kryerja e detyrës.

KREU I TRETË

MARDHËNIET FINANCIARE

Neni 16

Shoqëria mund të lidhë kontrata me sektor shtetëror, drejtpër drejt me tregun e lirë si dhe me persona fizik e juridik vëndas e të huaj sipas legjislacionit në fuqi që përputhjen me veprimtarin e ekonomisë së tregut.

Neni 17

Në veprimet kontraktore shoqëria përfaqësohet nga administratori ose nga persona të tjerë të autorizuar prej tij.

Neni 18

Të drejtat e detyrimet që rrjedhin nga kontratat janë të dety rueshme për shoqërinë dhe për punonjësit e saj.

Neni 19

Shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, afatet e derdhjes së tij detyrimet ndaj shtetit, sigurimet shoqërore. Shoqëria ka të drejtë të çel llogari likujduese pranë bankave të vëndit dhe të kryej veprimet e likujdimit nëpërmjet tyre.

Neni 20

Në pasqyrimin e veprimtarisë së shoqërisë administratori ose persona të tjerë të caktuar prej tij janë të detyruar të mbajnë dokumenta të rregullta financiare dhe rregjistrat përkatëse sipas ligjit të veçantë.

Neni 21

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë mbyllet në muajin Dhjetor të çdo viti. Administratori është i detyruar të paraqesë bilanc vjetor së bashku me deklaratën e të ardhurave, fitimeve e humjeve dhe ti dorëzojë ato në zyrën tatimore të rrethit ku ka selin shoqëria

BILANCI E TË ARDHURAT

Neni 22

Të ardhurat neti pas shlyerjes së detyrimit fiskal, sigurimeve shoqërore e tj, kalojnë në pronësi të ortakut themelues.

Neni 23

Shpërblimi për personat e punësuar në veprimtarinë e shoqërisë caktohen sipas kontratës së punës.Ndryshimi në pagë dhe rritje e përqin jeve të shpërblimit vendoset nga ortaku themelues ose me autorizim të tij prej administratorit.

Neni 24

Të ardhurat nga veprimtaria private do të sigurohen nga çmimet që vendos shoqëria.çmimet e tarifat do të caktohen sipas kërkesës dhe ofertës dhe sipas dispozitave të tjera në këtë fushë.

Neni 25

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi financiar,të cilat i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën sipad ligjit dhe nga ana tjetër do të zbriten ose shtohen respektivisht humbjet apo fiti met mbartura nga vitet e mëparëshme.

MARDHENIET E PUNESIMIT

Neni 26

Ortaku themelues i shoqërisë vendos për shtimin apo pakësimin e numrit të fuqis puntore që do të punësohen në veprimtarinë e shoqërisë.

Neni 27

Mardhëniet e punësimit rregullohen sipas kontratës që lidhet lirisht midis palëve.Kontrata lëshohet nga administratori.

Neni 28

Marja në punë nga punëdhënësi bëhet me rregjistrimin e punonjësve në librin e shoqërisë sidhe duke njoftuar organet e punës të juridiksio nit ku ushtron veprimtarinë shoqëria.

Neni 29

Kontrata e punës mund të lidhet me ose pa afat sipas kritereve të caktuara themeluesi dhe në mungesë të tyre sipas ligjit "Mbi mardhëniet e punës". Kontrata e punës përmban të gjitha kushtet që lidhen me pagat shpërblimin,kohën e punës,disiplinën në punë,pushimin e tj.

Neni 30

Largimi nga shoqëria dhe transferimi në një punë tjetër bëhen në bazë të një akti me shkrim nga administratori.Dorëzimi i detyrës bëhet pasi të jenë likujduar detyrimet materiale monetare.

KREU I KATERT

Shpërberja,prishja e shoqërisë,likujdimi

Neni 31

Shoqëria prishet me përfundimin e afatit të caktuar me përjashtim kur vendoset nga ortaku themelues zgjatja e afatit të veprimtarisë së saj.

Neni 32

Në rast se kapitali i shoqërisë për shkak të humbjeve të shkaktuara

që në dokumentet financiare rezultojnë më të vogla se gjysma e kapitalit themeltar, ortaku themelues mund të vendosë për prishjen e shoqërisë.

Shoqëria mund të prishet në rast se kapitali i saj zvogëlohet nën vlerën 100000 lekë.

Neni 33

Shoqëria hyn në proçesin e likujdimit që në momneitn e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij proçesi ortaku themelues emëron një ose disa likujduesa, të cilët i përaqesin atij raportin mbi gjëndjen e aktivit dhe të pasivit të shoqërisë, mbi ndjekjen e veprimeve të likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

Në fund të proçesit të likujdimit vendoset mbi bilancin përfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmërisë në punës së likujduesit dhe mbi mbylljen e proçesit të likujdimit.

Mbas pagimit të kreditorve dhe shlyerjes së pjesëve të kapitalit themeltar ortakut themelues, likujduesi ndan duke i dhënë ortakut themelues kapitalet e mbetura?Mbas kësaj largohen paisjet e objektit.

MOSMARVESHJET

Neni 34

Të gjitha mosmarveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë në marrëdhëniet me persona fizik ose juridik vendas ose të huaj, zgjidhjen me mirkuptim, në të kundërtën kur, kjo nuk arrihet zgjidhen nga gjykata e rrethit kompetent.

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 35

Ortaku themelues, në rast të shtimit të ortakve të tjerë ose të ndryshimeve të tjera në statut, duhet të bëjë ndryshimet e nevojëshme në organet përkatëse ku është rregjistruar shoqëria.

Neni 36

Përsa nuk është shprehur në këtë statut do të zbatohen dispozitat ligjore të përmëndura në pjesën hyrëse të nenit 1 të këtij statuti.

Neni 37

Ky statut u hartua në Berat më dt. 2.5 1995 në katër kopje, të cilat kanë të njëjtën vlerë në fuqi.

ORTAKU THEMELUES

Mynyr Shehu

[signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERE MANUSHAQE SELMANI
Nr. 1477/869

**VERTETIM**

Sot më datën 2.5 1995, para meje noteres Manushaqe Selmani, në Berat u paraqit personalisht shtetasi Mynyr Shehu, biri i Abazit, dtl.1955, banues në Pobrat, madhor e me zotësi të plotë për të

10708

# K Ë R K E S Ë

e

**KËRKUESIT:** Mynyr Shehu, biri i Abazit, dtl.1955, banues në Pobrat

**OBJEKTI:** Rregjistrim si person juridik të shoqërisë me përgjgjësi të kufizuar "SHEHU", sipas nenit 5 të ligji 7512 datë 10.8.1991, Për veprimtarin private: e nismën e lirë.

GJYKATËS SË RRETHIT

**T I R A N Ë**

Jam me banim në në fshatin Pobrat. Do të ushtroj veprimtari private si person juridik shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Por për të filluar këtë veprimtari private është e detyrueshme që të rregjistrohem si person juridik para asaj gjykate.

Selia e shoqërisë do ë jetë në fshatin Pobrat, emri i shoqërisë do të jetë "SHEHU", Kjo shoqëri do të ushtrohet me ortak të vetëm, dhe me dministrator dhe me hheleues të shoqërisë krijuesin e saj Mynyr Shehu

Kapitali themeltar i shoqëris së është 100000 mijë lekë.

Kësaj kërkese i bashkangjisë aktin e themelimit ë shoqërisë dhe statutin mbi bazën e të cilit do të suhtrohet veprimtaria private e cila ka për objekt: Tregëtim karburanti e lubrifikante të ndryshme artikuj të ndryshëm me pakicë e shumicë, prodhim e tregëtim material ndërtimi, tregëtim armë gjuhetie imort eksporti .

KËRKUESI
MYNYR SHEHU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NOTERE MANUSHAQE SELMANI
Nr. 1472/870

# V Ë R T E T I M

Sot më datën 2.5.95 para meje noteres Manushaqe Selmani në Berat u paraqit shtetasi Mynyr Shehu, biri i Abazit, dtl.1955, banues në Pobrat i panjohur prej meje por për indentitetin e tij u sigurova nga letër njoftimi personal me nr. 480657 i cili me paraqitjen e ij deklaroi se këtë akt e ka bërë jashtë kësaj zyre ka pasqyruar vullnetin e tij të lirë e ka firmosur rregullisht gjë që vërtetohet edhe nga unë noterja.

NOTERE
Manushaqe Selmani

15 10708/1

Z.y A Xhanhoj 07.02.2001

07 FEB. 2001

# K Ë R K E S Ë

**KËRKUESI :** Mynyr Shehu i biri Abazit lindur më 1955 banues Pobrat Bera

**OBJEKTI :** Kërkohet pasqyrimi i ndryshimeve të shoqërisë Shehu shpk konform më ligjës 7667 datë 28.1.1993 dhe ligjës 7638 datë 19.11.1992.

**PËRPARA :** GJYKATËS RRETHIT GJYQËSOR

[illegible] I A N Ë

Me vendimin Nr.10708 datë 9.5.1995 jam regjistruar si person fizik privat që ushtroj aktivitet konform më ligjës dhe statutit të shoqërisë.

Me vendimin Nr. 1 datë 5.2.2001 të ortakut të vetëm është emëruar administrator i shoqërisë zoti Nadir Shehu. Po me këtë vendim është miratuar kontrata e shitjes kapitalit të shoqërisë time zotit Nadir Shehu.

Duke qënë si më sipër kërkoj nga ana e juaj pasqyrimin e ndryshimeve në regjistrin tregëtar të asaj gjykate.

KËRKUESI

/ Mynyr Shehu /

REPUBLIKA E SHQIPERISË
NOTER LUAN ISUFAJ
Nr. 177/156

Datë 5.02.2001

# V Ë R T E T I M

Sot më datën 5.02.2001 para meje noterit u paraqit shtetasi i sipërm person madhor e me zotësi tëplotë juridike për të vepruar për të cilin u sigurova konform më ligjës i cili me vullnet të lirë nënshkroj sa sipër dhe unë noteri pasi veprimin e tij e gjej në pajtim të plotë me ligjën e vërtetoj rregullisht atë.




N O T E R I

/ Luan Isufaj /

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTER LUAN ISUFAJ

Nr. 275/158

Datë 5.2.2001

**KONTRATË SHITJE KUOTES KAPITALIT**

Sot më datën 5.2.2001 para meje noterit u paraqitën :

SHITSI :Shoqëria Shehu shpk përfaqsuar nga administratori Mynyr Shehu.

BLERESI : Nadir Shehu i biri Abazit lindur 1965 banues Pobrat Berat

Me paraqitjen e tyre shtetasit e sipërm,persona madhorë e me zotësi të plotë juridike për të vepruar për të cilët u sigurova konform ligjës kërkuan redaktimin e kontratës shitjes kapitalit si vijon :

Shitsi i sipërm deklaron se është pronar i vetëm i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar SHEHU shpk me kapital themeltar 100 000 lekë i gjithë pronë e tij.Gjithë kapitalin e shoqërisë sipërme pronë e tij ai ja shet zotit Nadir Shehu duke hequr dorë përfundimisht nga shoqëria Shehu dh se ai ka marrë tërësisht vlerën e kapitalit të shoqërisë.- - - -

Nga ana e vet bleresi Nadir është plotësisht dakort me sa sipër ka paguar shumën prej 100 000 lekë ,vlerë kjo e kuotave të kapitalit të shoqërisë Shehu shpk dhe me firmosjen e kësaj kontrate ai bëhet pronar i vetëm i ligjshëm i shoqërisë SHehu shpk.- - - - - - - - -

Të dy palët pasi konstatojnë se kontrata shpreh vullnetin e tyre të lirë e nënshkruajnë pa vrejtje atë dhe unë noteri pasi veprimin e tyre e gjej në pajtim të plotë me ligjën e vertetoj rregullisht.

SHITSI / Mynyr Shehu /

BLERESI / Nadir Shehu /

NOTERI / Luan Isufaj /



**VENDIM Nr. 1**

**I ORTAKUT TË VETËM**

Në Berat sot më datën 5.2.2001 unë ortaku i vetëm Mynyr Shehu banues në Petrat Berat,me cilësinë e administratorit dhe pronarit të shoqërisë me përgjegjsi të kufizuar SHEHU shpk shoqëri kjo e regjistruar në gjykatën e rrethit Tiranë me vendimin Nr. 10708 datë 9.5.1995 me vullnetin tim të lirë :

**V E N D O S A**

1.Aprovimin e kontratës shitjes kapitalit të shoqërisë zotit Nadir Shehu.

2.Administrator i shoqërisë do të jetë zoti Nadir Shehu.

3.Të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistrin tregëtar të gjykatës rrethit Tiranë.

ORTAKU THEMELUES

/ Mynyr Shehu /

REPUBLIKA E SHQIPERISË

NOTER LUAN ISUFAJ

Nr. 278/157

Datë 5.02.2001

**V Ë R T E T I M**

Sot më datën 5.02.2001 para meje noterit u paraqit shtetasi i sipërm person madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar për të cilin u sigurova sipas ligjës i cili me vullnet të lirë nënshkroj sa sipër dhe unë noteri pasi veprimin e tij e gjej në pajtim të plotë me ligjën e vërtetoj regullisht atë.




N O T E R I

/ Luan Isufaj /

10708/2

31 MAG. 2007

## KËRKESË

**KËRKUES**: Nadir Shehu, administrator i shoqërisë "SHEHU" SH.P.K." sh.p.k

**OBJEKTI**: Kërkohet depozitimi pranë Regjistrit Tregtar i Vendimit Nr. 1, dt. 23.05.2007 të Ortakut te vetëm të shoqërisë "SHEHU." sh.p.k.

**PËR KOMPETENCË**: **GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR, TIRANË**

Shoqëria "SHEHU SH.P.K." sh.p.k është regjistruar si person juridik, me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tirane Nr. 10708, dt. 9. 05.1995.

Me datë 23.05.2007, ortaku, me Vendim Nr. 1, ka vendosur caktimin e ekspertes kontabël, Semiha Dollani, me qëllim vlerësimin e kapitalit dhe shtesës së tij.

Kërkoj nga gjykata, depozitimin e këtij vendimi në Regjistrin Tregtar, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ADMINISTRATORI

NADIR SHEHU

Republika e Shqipërisë
Dhoma e Noterisë

Nr. 887 Rep.

## VËRTETIM

Sot, më 28.05.2007, përpara meje noterit ____________, u paraqit personalisht z. Nadir Shehu, me nr. paspaporte ____________, lindur me ____________, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, i cili deklaroi se sa më sipër është një kërkesë e redaktuar prej tij, nënshkroi përpara meje dhe unë noteri vërtetoj se firma e tij është autentike

NOTER

PULLË TAKSE
100
LEKE
R. SHQIPERISE

(1)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA "SHEHU" SH.P.K.
BERAT

# VENDIM
# I ORTAKUT TË VETËM

**Nr. 1, datë 23.05.2007**

Sot më datë 23.05. 2007 Ortaku i vetëm i shoqërisë "SHEHU" sh.p.k. Berat mori ne shqyrtim problemin e shtesës së kapitalit dhe në përputhje me Ligjin 7638, datë 19.12.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe statusin e shoqërisë,

Vendosi:

1. Caktimin e ekspertes kontabël të shoqërisë zj. Semiha Dollani, për të kryer aktin e vlerësimit të kapitalit dhe të shtesës së tij.

2. Depozitimin e këtij vendimi ne Regjistrin Tregtar, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Berat më, 23.05. 2007

ORTAKU
NADIR SHEHU

IMPORT-EKSPORT SHEHU BERAT ALBANIA

Republika e Shqipërisë
Dhoma e Noterisë

Nr. 386/268 Rep.

## VËRTETIM

Sot, më 23-05-2007, përpara meje noterit A. Berati, u paraqit personalisht z. Nadir Shehu, me nr. pasaporte 2074 7710, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, i cili deklaroi se sa më sipër është një Vendim i redaktuar prej tij, nënshkroi përpara meje dhe unë noteri vërtetoj se firma e tij është autentike




NOTER

10708/3

Gj. B. Musa
dt. 08.06.2007

08 GIU. 2007

# KËRKESË

**KËRKUES**: Nadir Shehu, administrator i shoqërisë " SHEHU" sh.p.k

**OBJEKTI**: Kërkohet depozitimi pranë Regjistrit Tregtar i Vendimit Nr. 2, dt. 25.05.2007 të Ortakut të vetëm të shoqërisë "Shehu" sh.p.k.

**PËR KOMPETENCË: GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË, TIRANË**

Shoqëria "Shehu" sh.p.k është regjistruar si person juridik, me Vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë Nr. 10708, dt. 9.05.1995.

Me datë 25.05.2007, ortaku, me Vendim Nr. 2, ka vendosur te rrisin kapitalin themeltar (kapitali nënshkruar ) për shumën 1.993.841 leke e cila përbehet:

1.Fitimi i vitit ne vazhdim 1.993.841 leke

Kërkoj nga gjykata, depozitimin e këtij vendimi në Regjistrin Tregtar, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Të depozitohet kërkesa dt 19.06.07

Vendimi i Ortakut të vetëm Nr 2 dt 25.05.07

Raport Ekspertimi

ADMINISTRATORI

NADIR SHEHU

Republika e Shqipërisë
Dhoma e Noterisë

Nr. 88P Rep.

## VËRTETIM

Sot, më 28.05.2007, përpara meje noterit A. Berdi, u paraqit personalisht z. Nadir Shehu, me nr. pasaporte 20747710, lindur me , madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, i cila deklaroi se sa më sipër është një kërkesë e redaktuar prej saj, nënshkroi përpara meje dhe unë noteri vërtetoj se firma e tij është autentike

PULLE TAKSE 100 LEKE R. SHQIPERISE

NOTER

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA "SHEHU" SH.P.K.
BERAT

# VENDIM
# I ORTAKUT TË VETËM

**Nr. 2, datë 25.05.2007**

Sot, më datë 25.05. 2007, Ortaku i vetëm i shoqërisë "SHEHU " sh.p.k, pasi shqyrtoi bilancin e vitit 2006 te shoqërisë "SHEHU " dhe raportin e ekspertes kontabël të datës 29.01.2007, që miratoi llogaritë vjetore të vitit 2006, në mbështetje të Ligjit 7638, date 19.12.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", neni 61,

Vendosi:

Të rrisë kapitalin themeltar (kapitali nënshkruar ) për shumën 1.993.841 lekë e cila përbehet:

1. Fitimi i vitit ne vazhdim 1.993.841 leke

Te depozitohet ky vendim ne Zyrën e Regjistrit Tregtar, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Berat më, 25.05. 2007

**ORTAKU I VETËM**
**NADIR SHEHU**

Republika e Shqipërisë
Dhoma e Noterisë

Nr. 888/26 Rep.

**VËRTETIM**

Sot, më 28.05.2007, përpara meje noterit A. Berati, u paraqit personalisht z. Nadir Shehu, me nr. pasaporte 30747710, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, i cili deklaroi se sa më sipër është një Vendim i redaktuar prej tij, nënshkroi përpara meje dhe unë noteri vërtetoj se firma e tij është autentike

PULLE TAKSE 100 LEKE R. SHQIPERISE

NOTER

"KONTALBA AUDITING" SH.P.K (*Semiha Dollani*)

# RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TE AUTORIZUAR PËR RRITJE KAPITALI

## Shoqërisë:
## «Shehu» sh.p.k.

Adresa: Rr."M. Gjollesha"
Pall. 1/1 Ap.14 Tiranë

*Tel*: + 355 4 2401 91
*Cel*: 069 23 90 978

INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TE AUTORIZUAR
EKSPERTE: SEMIHA DOLLANI

## RAPORT I VEÇANTË

## MBI RRITJEN E KAPITALIT TË NËNSHKRUAR TË SHOQERISE

## "SHEHU" SH.P.K.
## BERAT

Në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Autorizuar jam caktuar me vendimin Nr. 10708/2 datë 06.06.2007 të Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane

, për verifikimin dhe vërtetësinë e shtesës së kapitalit të shoqërisë "Shehu" sh.p.k., ku paraqes raportin tim si më poshtë vijon:

Shoqëria "SHEHU" sh.p.k është krijuar me vendim nr. 10708, datë 9.05.1995 të Gjykatës së Rrethit Tiranë.
Me vendimin nr. 1, datë 23.05.2007 shoqëria "Shehu" sh.p.k bazuar ne statutin e shoqërisë, ka caktuar eksperte kontabël për rritje të kapitalit themeltar .

Shoqëria ka për objekt te veprimtarisë se saj tregtim me shumice e pakice import-eksport te karburanteve.

Ne momentin e krijimit te saj kapitali i nënshkruar ishte 100.000 leke. Mbas rritjes së bërë me vendimin nr 2, date 25.05.2007 të ortakut të vetëm, Z. Nadir Shehu, kapitali themeltar bëhet 2.093.841 lekë

Me datë 26.05.2007, ortaku i vetëm, me Vendim Nr. 2, ka vendosur të rrisë kapitalin themeltar (kapitali nënshkruar ) për shumën 1.993.841 leke e cila përbehet:

1. Fitimi i vitit ne vazhdim 1.993.841 leke

Aktualisht ne bilancin e vitit 2006 shoqëria ka fitime te pa shpërndara te cilat janë krijuar gjatë veprimtarisë së saj me vlerë 1.993.841 leke.

Këtë fitim ortaku i vetëm ka vendosur ta shtojë në kapitalin themeltar

Për kryerjen e misionit qe m'u ngarkua për vërtetimin e shtesës së kapitalit të nënshkruar, unë në përputhje me normat profesionale jam mbështetur në dokumentet e mëposhtme:

1. Bilancet e shoqërisë deri ne 31.12.2006.

2. Raportet e auditimit të këtyre bilanceve.
3. Në dokumentet ligjore të shoqërisë .
4. Në vendimin e ortakut të vetëm për shtesën e kapitalit të shoqërisë.

Nga shqyrtimi i dokumenteve kontabël dhe inventarëve të fundit të vitit 2006, rezulton se pasqyrimi i pasurisë së shoqërisë në bilance dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 7661 datë 19.01.1993 "Për Kontabilitetin" i ndryshuar

Në fund te vitit 2006 shoqëria " Shehu " sh.p k. ka te pasqyruar ne grupin e "Kapitaleve te veta" vlerën 1.480.728 lekë të ndarë në llogaritë përkatëse si:

| | |
|---|---|
| Kapitali nënshkruar për shumën | 100.000 leke |
| Rezerva ligjore | 10.000 leke |
| Rezerva te tjera | 7.687.250 leke |
| Fitime te vitit | 1.993.841 leke |

Shoqëria zotëron një pasuri ne aktive qarkulluese të vërtetuar me inventar fizik të gjendjes së mallrave e likuiditeteve 6.119.178 leke te ndara në:

| | |
|---|---|
| Inventare | 5.767.687 leke |
| Te tjera Kërkesa | 159.004 leke |
| Likuiditete ne banke | 173.452 leke |
| Vlera ne arke | 19.035 leke |

Vërtetohet me dokumente kontabile derdhjet dhe likujditetet nga te tretet. Ato janë evidentuar drejtë dhe tregojnë realitetin e shoqërisë

Për sa më sipër, kapitalit të nënshkruar të shoqërisë mbi bazën e vendimit të ortakut të vetëm, mbas vërtetimit nga ana ime, i shtohet vlera prej 1.993.841 lekë . Vlera e shtuar në kapitalin themeltar është e barabarte me fitimin e vitit 2006 për shumën 1.993.841 leke .

**SI PËRFUNDIM: Unë vlerësoj se kapitali i nënshkruar i shoqërisë "Shehu" sh.p.k. rritet për vlerën prej 1.993.841 leke. Mbas rritjes se mësipërme kapitali themeltare behet 2.093.841 leke, ai përbehet nga një ortak i vetëm , Z. Nadir Shehu.**

**Ju faleminderit**
**Semiha Dollani**

EKSPERTE KONTABEL
SEMIHA DOLLANI
NR . 129
TIRANË
KONTABEL AUDITIM

**Tiranë, më 25. 05. 2007**

## "SHEHU" SH.P.K.

*Bilanci Kontabel me 31 Dhjetor 2006*
*(shumat ne Leke)*

| | Behet | Ishte |
|---|---|---|
| ***Aktivet*** | | |
| Aktive te Qendrueshme | | |
| te patrupezuara | 0.00 | 0.00 |
| te trupezuara | 19,722,879.00 | 19,722,879.00 |
| amortizim akumuluar | (3,236,578.00) | (3,236,578.00) |
| Totali Aktiveve te Qendrueshme | 16,486,301.00 | 16,486,301.00 |
| Aktive Qarkulluese | | |
| Inventare | 5,767,687.00 | 5,767,687.00 |
| Kliente per sherbime | | |
| Personeli dhe persona | | |
| Te tjera kerkesa | 159,004.00 | 159,004.00 |
| Llogari rrjedhese ne Banke | 173,452.00 | 173,452.00 |
| Arka | 19,035.00 | 19,035.00 |
| Totali i Aktiveve Qarkulluese | 6,119,178.00 | 6,119,178.00 |
| Difernca konvertimi aktive | 0.00 | 0.00 |
| Shpenzime per tu shperndare | 0.00 | 0.00 |
| ***Totali i Aktiveve*** | **22,605,479.00** | **22,605,479.00** |
| ***Pasivi*** | | |
| Kapitalet e veta | | |
| Kapitali i nenshkruar | 2,093,841.00 | 100,000.00 |
| Diferenca nga rivleresimet | | |
| Rezerva statutore | 10,000.00 | 10,000.00 |
| Rezerva te tjer | 7,687,250.00 | 7,687,250.00 |
| Fitime/Humbje te mbartura | | |
| Fitime dhe Humbje | | 1,993,841.00 |
| Totali i Kapitaleve te veta | 9,791,091.00 | 9,791,091.00 |
| Subvencione per investime | | |
| Detyrime te kerkueshme | | |
| Huara te tjera | 7,944,180.00 | 7,944,180.00 |
| Suma te arketuara per porosi | 1,760,800.00 | 1,760,800.00 |
| Furnitore per blerjee sherbime | 1,544,715.00 | 1,544,715.00 |
| Personeli & Sigurime shoqeror | 22,244.00 | 22,244.00 |
| Ortake | 1,350,000.00 | 1,350,000.00 |
| Shteti Tatim Taksa | 192,449.00 | 192,449.00 |
| Te tjera detyrime | | |
| Totali i Detyrimeve | 12,814,388.00 | 12,814,388.00 |
| Diferenca Konvertimi pasive | 0.00 | 0.00 |
| ***Totali i Pasiveve*** | **22,605,479.00** | **22,605,479.00** |

EKSPERTE KONTABEL
SEMIHA DOLLANI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr 4117 Rep
Notere Suzana JASHARI
Adresa : Rruga " Kont Urani " Pall 20.
Prane Ish Gjykates Rrethit
Cel : 0692101068

Taksa e Pullës u pagua

# VERTETIM

Sot, me date 15 Qershor 2007 ( dymije e shtate ) ne Zyren e Noterise Tirane para meje noteres Suzana JASHARI me adrese rruga " Kont Urani " Nr 20, u paraqit personalisht:
**Semiha DOLLANI, Eksperte Kontabli, rregjistruar me vendimin Nr. 31059 date 20.09.2004, te Gjykates Rrethit Gjyqesor Tirane, rregjistruar ne Organin Tatimor me Nr serie 002755, NIPT K414226056L,** e cila deklaroi se se Raporti I Ekspertit Kontabel " Per Rritje Kapitali " qe I perket **shoqerise " SHEHU " shpk**, eshte perpiluar,nenshkruar dhe vulosur prej saj, une noteri pasi u binda per identitetin e te lartepermendures, vertetoj vertetimin dhe e nenshkrimit.

**NOTER**

**SUZANA JASHARI**